



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 574, datë 20.11.2020

PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z.GENTIAN MEDJA
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS
ADMINISTRATIVE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.245, DATË 09.07.2020, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË
VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.11.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. Gentian Medja”, përgatitur nga relatori z. Ilir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. Gentian Medja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 245, datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

2. Në këtë vendim afati i kandidimit është përcaktuar “*deri më datë 30.07.2020*”.

3. Ky vendim i Këshillit është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 09.07.2020, duke filluar të ecë afati i kandidimit nga dita e nesërme, pra nga data 10.07.2020.

4. Brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion të lirë, ka kandiduar edhe gjyqtari z.Gentian Medja (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. Më herët, me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative. Për këto dy pozicione të lira ka kandiduar edhe gjyqtari z.Gentian Medja.

6. Me Vendimet nr. 151, datë 06.05.2020 dhe nr. 201, datë 11.06.2020, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët që kanë kandiduar, ndër të tjerë, edhe për dy pozicionet e lira sipas pikës 5 të këtij vendimi, përfshirë edhe për kandidatin z.Gentian Medja. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidatit në fjalë, me short, si relator, është caktuar anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z.Illir Toska. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019), si dhe pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatit në lidhje me tre kriteret formale¹ të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira të shpallura me këto vendimi, që të dyja në fushën e të drejtës administrative. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 216, datë 18.06.2020, Këshilli vendosi:

“1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidati z.Gentian Medja, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr.83, datë 26.02.2020. ...”.

7. Aktualisht kandidati është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së këtij kandidati në kuadër të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

8. Ndërkohë, mbas përfundimit të afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative sipas pikës 1 të këtij vendimi, Këshilli, me Vendimin nr.268, datë 07.08.2020, vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të

¹ Tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

shpallura, ndër të tjerë, edhe me vendimin në fjalë². Në këtë rast, sipas këtij vendimi³, procedurat e verifikimit për kandidatët të cilët kishin kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, do të vijonin të kryheshin nga të njëjtët relatorë, bazuar kjo në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit 75/2019, ku përcaktohet se: *“Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”*. Referuar këtij përcaktimi, në pikën 4 të vendimit, Këshilli vendosi që për kandidatin z.Gentian Medja, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime (*nënkupto këtu Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020*), është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë, të shpallur me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020.

9. Më datë 08.08.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020.

10. Në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr.245, datë 09.07.2020, sikurse në të njëjtën pikë edhe të Vendimeve të tij nr.82 dhe nr.83, datë 26.02.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, bazuar në nenin 136, pika 3 (fjalja e parë), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, pika 2, në nenin 47, pika 5 dhe në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, në Vendimin e Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020 (pika 5, shkronja “a”) përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

11. Sa i përket verifikimit të plotësimit nga kandidati z.Gentian Medja të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, pra të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në kushtet kur kandidati është verifikuar për plotësimin e këyre kriterëve në kuadër të kandidimeve të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për dy pozicionet e tjera të lira në të njëjtën fushë të së drejtës, pra atë administrative⁴, u çmua se nuk

² Vendimin nr.245, datë 09.07.2020.

³ Vendimi nr. 268, datë 07.08.2020.

⁴ Për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020.

kishte vend për kërkimin dhe administrimin përsëri të të njëjtit dokumentacion zyrtar, duke qenë i vlefshëm për qëllimet e këtij verifikimi dokumentacioni i administruar më parë. Gjithsesi, për kriteret e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” u kryen disa veprime verifikuese, sikurse do të përshkruhen më poshtë, në funksion të verifikimit të ekzistencës së ndonjë të dhëne të ndryshme nga sa më parë, kjo për shkak se këto rrethana janë potencialisht të ndryshueshme qoftë edhe në një kohë të shkurtër.

12. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit paraprak në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit për kandidatin Gentian Medja për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 26.08.2020, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

13. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 28.08.2020 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për verifikimin e plotësimit ose jo nga kandidati z. Gentian Medja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.245, datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

14. Më datë 09.09.2020, bazuar në nenin 146, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr.101/2020 (miratuar më datë 23.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 4 Gusht 2020 dhe hyrë në fuqi më datë 19.08.2020), z.Gentian Medja u përzgjedh me short si anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Zgjedhja e tij në këtë detyrë u miratua me Vendimin nr.293, datë 09.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si rezultat i kësaj, ndërsa sipas shkronjës “b”, pika 1, të nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej se “*Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund: ...; b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe ... apo ngritje në detyrë*”, procedura e verifikimit nuk vijoi në pritje të shqyrtimit nga Kuvendi i Shqipërisë të nismës ligjore, ndër të tjera, edhe për ndryshimin e kësaj dispozite. Me Ligjin nr.118/2020, u shfuqizua togfjalëshi “*apo ngritje në detyrë*”, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 149, të Kodit Zgjedhor. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 3 nëntor 2020, duke hyrë ai në fuqi më datë 18.11.2020.

15. Për rrjedhojë, me rënien e pengesës ligjore më datë 18.11.2020, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit paraprak u përfshi në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 20.11.2020.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

16. Për kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

17. Plotësimi nga kandidati i kriterit të “përvojës profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, është verifikuar me parë nga Këshilli në kuadër të kandidimeve të mëparshme të tij për dy pozicione të lira në këtë fushë të së drejtës, referuar për këtë Vendimit të tij nr. 216, datë 18.06.2020, në të cilin është arritur në përfundimet se:

“22. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z.Gentian Medja, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, ka mbi trembëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

25. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z.Gentian Medja, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.”

18. Kandidati z.Gentian Medja, sikurse më herët, edhe në rastin e kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, ka kandiduar për të njëjtën fushë të së drejtës, atë administrative dhe për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me këtë vendim, ai ka mbi trembëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, nga të cilat mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative”, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale” dhe “kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

19. Për kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

20. Në rastin e kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 27.07.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

21. Në rastin e procedurës së verifikimit në kuadër të kandidimit për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, ka rezultuar se kandidati z.Gentian Medja nuk kishte masa disiplinore në fuqi, ndërsa në pikën 30, të Vendimit nr. 216, datë 18.06.2020, Këshilli ka arritur në përfundimin se: *“Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z.Gentian Medja të ketë masë disiplinore në fuqi”.*

22. Ndërkohë, pra mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 216, datë 18.06.2020, nuk rezulton që ndaj kandidatit të jetë marrë ndonjë masë disiplinore⁵. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z.Gentian Medja të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

23. Për kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

24. Në rastin e kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 27.07.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*”.

25. Në rastin e procedurës së verifikimit në kuadër të kandidimit për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, në pikën 35 të Vendimit të tij nr. 216, datë 18.06.2020, Këshilli ka arritur në përfundimin se: “*Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z.Gentian Medja nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë*”.

26. Ndërkohë, mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 216, datë 18.06.2020, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet ekzistenca e ndonjë rrethane të ndryshme nga sa është konstatuar më parë në lidhje me qenien e kandidatit z.Gentian Medja në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

27. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 245, datë 09.07.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të z. Gentian Medja, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

28. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidatin z. Gentian Medja, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. Gentian Medja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore në

⁵ Referuar nenit 105 të Ligjit për Statusin vendosja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 245, datë 09.07.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 245, datë 09.07.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.Gentian Medja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.245, datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.245, datë 09.07.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.Gentian Medja sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR